



PK. SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Posta Kosova D.D.

Nr./No./Br. 01-1705/24
Data/Date/Datumi 16-07-2024
PRISHTINË-PRISTINA-PRISTINA



POSTA E KOSOVËS SH. A.

AGJENCIA SHITETËRORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT / MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS
AGJENCIA SHITETËRORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS / DRŽAVNA AGENCIJA ARHIVA KOSOVA
STATE AGENCY OF KOSOVO ARCHIVES

Nr./Br./No. 01/213/24
Data/Datum/Date: 16.07.2024

ANEKS

MARREVESHJE BASHKEPUNIMI MES
AGJENCISË SHITETËRORE TË ARKIVAVE TË KOSOVËS DHE
POSTES SË KOSOVËS SH.A.

MBI

PROCEDURAT STANDARDE OPERATIVE (PSO)

PËR PRANIM TË APLIKACIONEVE DHE DORËZIM TË DOKUMENTEVE DHE
MATERIALEVE TË NDRYSHME NGA
AGJENCIA SHITETËRORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS

Prishtinë
Korrik, 2024

HYRJJE

Me këtë Aneks të marrëveshjes bashkëpunimit, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës dhe Posta Kosovës SH.A (në tekstin e mëtejme referuar si: palët) janë pajtuar të vendosin kornizën e bashkëpunimit dhe të akordojnë procedurat standarde të operimit për ofrimin shërbimeve përmes sporteleve të zyrave postare në pranimin/dërgimin e kërkesave/aplikacioneve të ndryshme për dokumente dhe materiale arkivore për të cilat, ASHAK është institucion kompetent, për gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Aneks marrëveshja e bashkëpunimit bazën e ka në marrëveshjen e arritur mes PK SH.A. dhe MPB & MAPL, nr. 030-656, nr. 01-1707/2021, datë” 16.07.2021, për ofrimin shërbimeve postare nga zona universale dhe jashtë saj për gjitha Institucionet e Republikës së Kosovës (IRK), dhe do të shërbejë për të përshkruar hapat dhe udhëzimet e nevojshme për zyrtarët e dy institucioneve në interes të zgjerimit të bashkëpunimit në mes NPQ Posta e Kosovës (*në vijim të tekstit NQP PK SH.A.*) dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (*në vijim të këtij teksti shkurtesa ASHAK*), të cilat kanë shprehur intersim për bashkëpunim konform aneks marrëveshjes së lartëcekur dhe në interes të realizimit efektiv të detyrave dhe synimeve brenda përgjegjësiive respektive.

Ky aneks i marrëveshjes së bashkëpunimit, shoqërohet me procedurë standarde operative (PSO), e cila është një grup udhëzimesh të hartuara për të ndihmuar zyrtarët të kryejnë operacione rutinë, respektivisht të përshkruajë hapat dhe udhëzimet e nevojshme që shpesh janë të një natyre komplekse ose të ndërlydhura. Qëllimi i PSO është synimi dhe arritja e efikasitetit, rezultateve cilësore dhe uniformitet të performancës, duke synuar që me resurset në dispozicion të arrihen rezultate të kënaqshme.

Aneksi në tërësi nënkupton respektimin e kornizës së Marrëveshjes së Bashkëpunimit të arritur mes PK SH.A. dhe MPB & MAPL, nr. 030-656, nr. 01-1707/2021, datë” 16.07.2021, për ofrimin shërbimeve postare nga zona universale dhe jashtë saj për gjitha Institucionet e Republikës së Kosovës (IRK), respektivisht pasojat juridike të Aneksit nuk mund të tejkalojnë fushëveprimin, afatet dhe çështjet tjera materiale të përcaktuara në marrëveshjen bazë.

Marrëveshja e bashkëpunimit me procedurat standarde operative (PSO) përfshin këto pika, si në vijim;

I. MËNYRA E BASHKËPUNIMIT, FUSHËVEPRIMI, AFATET, PËRGJEGJËSITË, TARIFAT DHE ÇËSHTJET TJERA TË RËNDËSISHME PËR QËLLIMIN E ANEKSIT

1. Ky bashkëpunim/pajtim bazohet nga marrëveshja e lartcekur dhe me këtë dakordim rregullohen dhe specifikohen shërbimet që do të realizohen mes dy institucioneve për shërbimet postare nga zona universale. Dy palët kontraktuese, bazuar në Marrëveshje mes PK SH.A. dhe MPB & MAPL dhe këtë Aneks, për ofrimin e shërbimeve postare, janë pajtuar për fillimin e shërbimit nga data; 18/07/2024, për pranimi të aplikacioneve dhe

dorëzim të dërgesave me shërbime postare me përmbajtje të dokumenteve dhe materialeve të ndryshme të lëshuara nga ASHAK, përmes shërbimeve të ofruar nga NQP PK SH.A.

2. Bazuar në Marrëveshjen bazë për ofrimin e shërbimeve postare, në veçanti nga zona e shërbimeve universale postare dhe shërbimeve tjera postare për institucionet e Republikës së Kosovës, Posta e Kosovës si operator publik postar, me qëllim të përmbushjes së plotë të këtyre pikave, zotohet se me përpikëri do t'i përmbushë kërkesat e ASHAK, por njëkohësisht edhe te qytetareve të Republikës së Kosovës.
3. Ofruesi i shërbimeve, në kuptim të këtij bashkëpunim, mund të ofrojë për ASHAK-në pranimin e aplikacioneve në gjitha zyrat postare, dorëzimin e kërkesave/aplikacioneve të ASHAK-së, dhe pas lëshimit të dokumenteve dhe materialeve të ndryshme t'i dorëzojë në adresën e qytetarit në trafikun vendor dhe ndërkombëtar sipas nevojës.
4. Këtë shërbim e karakterizon siguria nga momenti i pranimin, përcjellja e informatës/kërkesës përmes shërbimit të ri postar si "postë e skanuar" deri në dorëzim me shërbim të sigurt dhe të shpejtë postar, si dhe gjurmim në çdo kohë përmes web faqes së PK
5. Bazuar në Marrëveshjen bazë për shërbime postare PK SH.A. dhe MPB & MAPL, nr. 030-656, nr. 01-1707/2021, datë 16.07.2021, PK SH.A. dhe ASHAK kanë dhënë pëlqimin për shfrytëzimin e shërbimeve që ofrohen nga PK Sh.A, të specifikuar për pranim të aplikacioneve, kryerjen e pagesave për dokumente dhe materiale sipas tarifave të ASHAK dhe tarifave për komisione (IFJB-se) të aprovuara nga PK SH.A., si dhe tarifën për shërbime postare për pranim dhe dorëzim dokumenteve dhe materialeve të ndryshme në adresë të secilës palë që kërkon qasje në dokumentacion arkivor sikurse është përcaktuar me legjislacionin në fuqi që rregullon fushën e arkivave.
6. Tarifën për aplikacione, shërbime postare dhe njoftimet tjera për pranimin e kërkesave/aplikacioneve do të publikohen në sportelet e zyrave postare të PK SH.A., në web faqet e dy institucioneve dhe rrjetet sociale në mënyrë që konsumatorët të jenë sa më shumë të informuar për këtë shërbim.
7. Tarifën standarde të ASHAK –së janë të aplikueshme sipas akteve juridike në fuqi të ASHAK –së ndërsa tarifën e Ofruesit të shërbimit janë të aplikueshme sipas përcaktimit në Marrëveshjen bazë, ndërsa tarifa për aplikim e ofruesit të shërbimit (Posta e Kosovës) është pjesë e shërbimeve tjera postare të cilën e përcakton kryesi i shërbimit.
8. Në aspektin e logjistikës për këtë proces, duke i përfshirë të gjitha punët operative nga marrja e informatës për kërkesa, pranimin e aplikacioneve në sportele të PK sh. a, pranimi i dokumenteve dhe materialeve të lëshuara nga ASHAK, dërgimi në përpunim në qendrën kryesore, përgatitja për transport, si dhe dërgimi në adresën e marrësit, përgjegjësinë dhe obligimet do t'i marrë ofruesi i shërbimit (PK Sh. A), i cili obligohet të përgatit edhe udhëzimin për gjithë procesin e këtij projekti.

8. Në aspektin operativ ky plan realizohet në çdo zyrë postare ku kërkuesi/aplikuesi bënë kërkesë për lëshim të kopjes së dokumentit nga ASHAK , ose me kërkesë nga personi me autorizim të noterizuar.

9. Zyrtari i postës (sportelisi) i verifikohen mirë kërkesën e konsumatorit për lëshim të kopjes së dokumentit (sipas udhëzimi dhe manualit dërguar secilës pikë / zyrë postare të pranimit, printon dhe plotëson: Fletë-aplikimi për kërkesën së konsumatorit për lëshim të kopjes së dokumentit dhe e përcjell me poste te skanuar ne ASHAK.

10. Pas pranimit të informatës për lëshimin e dokumentit nga ASHAK, dërgesa së bashku me fletëpagesat tërhiqet nga ASHAK dhe dërgohet në zyrën postare e cila e ka bërë pranimin e kërkesës për dorëzim te aplikuesi me shërbim të shpejtë postar EMS.

11. Afatet dhe përmbajtja e dokumentacionit është përgjegjësi e ASHAK sipas legjislacionit ne fuqi me te cilën janë te përcaktuara këto afate ligjore.

12. Për parregullsi dhe dëmtimet eventuale të përmbajtjes së dërgesës gjatë kryerjes së shërbimit postar, si në transport dhe në dorëzim përgjigjet kryesi i shërbimit, në përjashtim të dëmtimeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore te parapara me ligj per shërbime postare.

13. Këtij aneksi i bashkëngjiten e tarifat nga ASHKA, aplikacioni për kërkesë, ndërsa tarifat për shërbime postare të PK sh. a., të aprovuar nga ARKEP janë të publikuar në web faqen e PK-se, dhe si e tilla mund të ndryshohen pas aprovimit nga ana ARKEP.

II. PERMBLEDHJE:

1. PALET janë pajtuar të nxjerrin gjitha udhëzimet, sqarimet, manualet, specifikimet e informatave të nevojshme të dokumenteve, materialeve dhe gjitha shënimet dhe informatat tjera të nevojshme për funksionalizimi e këtij shërbimi.

2.Këto pika hyn në fuqi ditën e konfirmimit nga të dyja palët dhe validitetin e kanë në Marrëveshjen bazë (PK Sh. A MPB dhe MAPL).

AGJENCIA SHITËTËRORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS:

Z. Bislir Bisliri- Drejtor Ekzekutiv i ASHAK-së

Data: ___/___/___

POSTA E KOSOVËS SH.A.

Znj. Nora Rraci - Kryeshere Ekzekutive e PK Sh.A.

Data: ___/___/___